



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:138316
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06787886

ARJ nr.125/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Lazić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit E.A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gafurr Elshani, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në P., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike anulim i vendimit të paditurës të datës 21.02.2022, duke vendosur sipas kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.921/2023, të datës 12.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30 Janar 2025, merr:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi E.A., kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.921/2023, të datës 12.07.2024.

II. Anulohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.921/2023, të datës 12.07.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1710/2022, i datës 16.10.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr.921/2023, të datës 12.07.2024, Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit E.A., e datës 07.11.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1710/2022, të datës 16.10.2023, vërtetohet.

Paditësi për mes përfaqësuesit të lartë cekur, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës , dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim, që: aprovohet kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ashtu që: të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi kontestues i lëshuar nga e paditura dhe ti njihet e drejta në pension të veteranit të UÇK-së, nga dita kur i është ndërprerë, e deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancë dhe pas vlerësimit të aktgjykimeve të goditura sipas pretendimeve në kërkesë dhe shqyrtimit edhe shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E.A.,ka ushtruar padi kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në P., me të cilën ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të datës 21.02.2022, me të cilin i është refuzuar ankesa e paditësit si e pa bazuar për njohjen e të drejtës në pension personal të veteranit të UÇK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e A.nr.1710/2022, të datës 16.10.2023, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit E.A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gafurr Elshani, avokat nga Prishtina , me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i datës 21.02.2022 i të paditurit.

Në arsyetim ndër të tjera thekson se: Gjykata e shkallës së parë konstatoi se vendimi i të paditurit nuk është në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së. Gjykata vërtetoi gjetjet e të paditurit në vendimin e kontestuar dhe konstatoi se organi i paditur me të drejtë kishte gjetur që paditësi kishte realizuar të ardhura në shtetin e tij të origjinës për çka me të drejtë, e kishte refuzuar ankesën e të njëjtit mbi bazën e nenit 16 paragrafit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ku përcaktohet: *“Neni 16 Pensioni personal i veteranit luftëtar 2. Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë. 4. Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit”*.

Gjykata po ashtu gjeti se organi i paditur drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur për marrjen e vendimit të kundërshtuar me padi është bazuar në të dhënat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në Tiranë ku i njëjti figuron si i punësuar ose i vet-punësuar. Duke u bazuar në këto prova dhe

në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike.

Gjykata e Apelit duke vendosur në procedurë ankimore, me aktgjykimin AA.nr.921/2023, të datës 12.07.2024, ka vendosur si në vijim: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit E.A., e datës 07.11.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1710/2022, të datës 16.10.2023, vërtetohet.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj gjykata e shkallës së dytë thekson se: gjykata e shkallës së parë, me të drejtë iu ka referuar nenit 16 paragrafit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ku përcaktohet: *“Neni 16 Pensioni personal i veteranit luftëtar 2. Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë. 4. Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit”*. Andaj duke u bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore-Dega e sigurimeve Shoqërore Tropojë të datës 26.11.2021 paditësi figuron si i punësuar ose i vet punësuar.

Tutje theksohet se: Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit, duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, konstatoi se vendimi i saj është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme, duke u nisur nga gjendja e tillë e kësaj çështje nuk mund të pranojë si të drejtë dhe ligjor qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të LKA, të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe si pasojë nuk janë vërtetuar faktet vendimtare lidhur me gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim, nga këto arsye nuk ekzistojnë kushtet ligjore për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, andaj aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të parashikuara nga nenin 182 par.2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kështu, në nenin 182 par.2 pika (n) të LPK parashikohet që shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete*

ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”.

Sipas nenit 16 paragraf 2, të Ligjit nr.04/L-261, përcaktohet se: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë”.*

Sipas nenit 4, të Ligjit Nr. 05/L-141 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14.04.2017, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, shtohet neni **16 A ,i cili në paragrafin 5, e përcakton**, citim; *“Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Veteranët e Luftës së UÇK-së, të cilët punojnë jashtë institucioneve që paguhet nga Buxheti i Kosovës, si dhe jashtë ndërmarrjeve publike, do të gëzojnë pensionin njëtrajtshëm sipas paragrafit 4 të këtij neni, deri në 50% të shumës së paraparë, por, që në total nuk do të kalojë buxhetin prej 0,7% të Bruto Prodhimit Vendor”, ndërsa paragrafi 4 përcakton se:” Pensioni mujor i Veteranit luftëtar, sipas kategorive, është: 4.1. Kategoria e parë, dyqind e pesëdhjetë (250) euro; 4.2. Kategoria e dytë, njëqind e shtatëdhjetë (170) euro; 4.3. Kategoria e tretë, njëqind e njëzet (120) euro”. 6. Në rast të tejkalimit të 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor, atëherë reduktimi i pensionit ndodhë në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj.*

Gjykata vlerëson se në këtë çështje konkrete gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë zbatuar drejtë dispozitat ligjore, përkatësisht ndryshim plotësimet e ligjit, të cilat i referohen rasteve për veteranët të cilët janë të punësuar, por që nuk financohen nga buxheti i Kosovës dhe që nuk janë të punësuar në institucionet publike. Në rastin konkret nuk paraqet rrethanë përcaktuese fakti nëse paditësi ka qenë apo jo i punësuar, por se a është paguar apo paguhet nga buxheti i Kosovës. Nga kjo gjendje faktike dhe juridike e kësaj çështje, pikëpamjet e lartpërmendura të gjykatave të instancave sipas mënyrës së vendosjes si në aktgjykimet e kontestuara, nuk mund të pranohen si të drejta dhe ligjore, për deri sa arsyet e paraqitura janë të paqarta, kontradiktore dhe jo në harmoni me dispozitat ligjore materiale të cekura si më lartë.

Nga kjo rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta është dashtë të veprojnë sipas dispozitës së lartcekur, nenit 16 A paragraf 5, të Ligjit Nr. 05/L-141 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, andaj në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave lidhur me vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, provave të tjera, dhe sipas nevojë nxjerrjen e provës për mes ekspertizës financiare si në vështrim të nenit 356 të LPK-së, lidhur me nenin 21 të Ligjit Nr.04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, duhet të vendos në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit duke nxjerrë vendim të drejtë gjyqësor të bazuar në prova dhe ligj.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54, paragraf 2 dhe 3, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ.nr.125/2024, më datë 30 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani